



Ju gëzoni të drejtën që të përfaqësoheni nga një avokat për këtë thirrje, duke përfshirë të drejtën e përdorimit të ndihmës së një avokati për përgatitjen e këtij formulari.

UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E DEKLARATËS NË MUNGESË PARAQITJEJE

Për t'u përfaqësuar me anë të një deklaratë me shkrim, plotësoni dhe nënshkruani formularin e Deklaratës në Mungesë Paraqitjeje (bashkëlidhur) dhe dërgojeni me postë në zyrën ku do të mbahet seanca dëgjimore. Ky formular duhet të merret të paktën dy javë përpara datës së seancës dëgjimore.

Në seancën dëgjimore, gjykatësi do të dëgjojë dëshminë e punonjësit të policisë dhe më pas do të lexojë deklaratën tuaj me shkrim të përfshirë në dosje. Gjykatësi do të shqyrtojë deklaratën tuaj me shkrim dhe çdo provë shoqëruese. Gjykatësi do t'ju shpallë “të fajshëm” ose “të pafajshëm”, njësoj si të ishit të pranishëm.

Si të plotësoni Deklaratën në Mungesë Paraqitjeje

1. Shkruani me germa shtypi emrin tuaj të plotë, adresën dhe numrin e gjobës.
2. Nëse keni më shumë se një gjobë, përdorni për secilën gjobë një formular të veçantë të Deklaratës në Mungesë Paraqitjeje.
3. Arsyetoni në mënyrë të detajuar se pse mendoni se jeni “të pafajshëm” ndaj akuzës/akuzave. Nëse është e nevojshme, përdorni faqe shtesë.
4. Vendosni nënshkrimin dhe datën në seksionin “Vërtetimi”.

Çfarë dokumentesh duhet t'i bashkëlidhni Deklaratës në Mungesë Paraqitjeje

1. Një fotokopje të lejes së drejtimit ose të një dokumenti tjetër identifikimi me fotografi, të lëshuar nga qeveria.
2. Çdo provë (dokumente, prova materiale, fotografi, deklaratë nën betim etj.) që dëshironi të shqyrtohet nga gjykatësi gjatë marrjes së vendimit për çështjen tuaj. (Këto artikuj nuk do t'ju kthehen).

Kur dhe ku ta dërgoni me postë Deklaratën në Mungesë Paraqitjeje

1. Deklarata në Mungesë Paraqitjeje dhe çdo provë duhet të merren të paktën 2 javë përpara datës së seancës dëgjimore.
2. Deklarata në Mungesë Paraqitjeje duhet t'i dërgohet me postë Byrosë së Kundërvajtjeve Rrugore ku do të mbahet seanca dëgjimore.
3. Nëse nuk jeni të sigurt për adresën e Byrosë së Kundërvajtjeve Rrugore, vizitoni dmv.ny.gov/pleadandpay ose telefononi (718) 488-5710.

Rikujtesa të rëndësishme (pasi të marrim deklaratën tuaj)

Nëse seanca juaj dëgjimore riplanifikohet, ne do ta përdorim deklaratën tuaj në çdo seancë pasardhëse dëgjimore. Ju do të njoftoheni për datën e re me postë, në mënyrë që të keni mundësinë të paraqiteni personalisht, nëse do të dëshironi.

Për pyetje të tjera apo për të kërkuar shtyrje

1. Mund të telefononi (718) 488-5710
2. Vizitoni dmv.ny.gov

Mosparaqitja e deklaratës në kohë, mungesa e paraqitjes personalisht apo shtyrja mund të sjellin:

- Pezullimin e të drejtave të drejtimit të mjeteve motorike; dhe
- Gjobë shtyrjeje prej 70 dollarësh



Emri: _____

Lënda: Numri i fletës së gjobës _____

Unë jam drejtuesi i mjetit motorik i përshkruar në fletën e gjobës së mësipërme. Jam akuzuar për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor dhe jam deklaruar “i pafajshëm” për këtë akuzë.

Adresa ime është: _____

Datëlindja ime është: _____ / _____ / _____

Kërkoj që gjykatësi i së drejtës administrative ta lexojë dhe ta marrë në konsideratë deklaratën time dhe ta bëjë atë pjesë të dosjes përpara se të marrë një vendim për çështjen time. Heq dorë nga e drejta ime për t’u paraqitur, për të pyetur dëshmitarët dhe/ose për të kundërshtuar çdo provë të paraqitur në seancën dëgjimore. E kuptoj se në këtë çështje do të marr pjesë nëpërmjet kësaj deklaratë.

E kuptoj se, në mungesën time, gjykatësi i së drejtës administrative dhe Departamenti i Mjeteve Motorike mund të ndërmarrin veprime ligjore të autorizuara kundër meje, njësoj si të isha i pranishëm në seancën dëgjimore. Këto veprime përfshijnë, ndër të tjera, caktimin e gjobave, pagesave dhe tarifave, si dhe pezullimin ose anulimin e lejes së drejtimit apo të të drejtave të drejtimit të mjeteve motorike dhe/ose regjistrimeve. Rezervoj të drejtën e apelimit të çdo vendimi kundër meje.

DUHET të shpjegoni pse mendoni se jeni “të pafajshëm”. DUHET të bashkëlidhni një kopje të lejes së drejtimit ose të dokumentit të identifikimit me fotografi, të lëshuar nga qeveria. *(Bashkëlidhni fletë të tjera, nëse është e nevojshme, dhe kopje të çdo prove.)*

VËRTETIM: Unë deklaroj, nën përgjegjësinë time të plotë, se i gjithë informacioni i dhënë në këtë deklaratë dhe në të gjitha dokumentet mbështetëse janë të vërteta. E kuptoj se dhënia e një deklaratë të rremë në lidhje me këtë deklaratë mund të më bëjë objekt të ndjekjes penale sipas së drejtës penale të shtetit të Nju Jorkut.

NËNSHKRIMI X

Nënshkrimi i drejtuesit të mjetit motorik

_____ / _____ / _____

Data